



UNIVERSITETI I PRISHTINËS
“HASAN PRISHTINA”
UNIVERSITY OF PRISHTINA

Rr. Xhorxh Bush, Ndërtesa e Rektoratit, 10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës
Tel:+381 38 244 183 · E-mail: rektorati@uni-pr.edu · www.uni-pr.edu

Fakulteti: Bujqësisë dhe veterinarisë

Departamenti: Lavërtari-Perimtari

Programi: Shkenca Bimore

NJOFTIM

Në bazë të rregullores për studime master të Universitetit të Prishtinës Nr. 1/334, datë 31.05.2023, Neni 12, pika 3 e kësaj rregulloreje, ju njoftojmë se :

Ekzemplari (drafti) i temës së masterit i punuar nga kandidati/ja Alban H. Krasniqi, me titull: temës “Hulumtimi i disa specieve foragjere për tipare sasiore dhe cilësore në lokalitetin e Malisheves” ndodhet në diskutim publik 7 ditë nga data 02.12.2024 deri me datë 09.12.2024.

Njëkohësisht në diskutim publik ndodhet edhe raporti i vlerësimit të dorëshkrimit nga komisioni në përbërje:

1. Prof. Dr. Sali Aliu- kryetar,
2. Prof. Dr. Imer Rusinovci-mentor/anëtar dhe
3. Prof. Asoc. Dr. Dukagjin Zeka- anëtar,

Ekzemplarin e draftit të temës dhe raportin e vlerësimit të dorëshkrimit nga komisioni mund ta kërkonit te udhëheqësi shkencor i temës Prof. Dr. Imer Rusinovci, përmes e-mail adresës imer.rusinovci@uni-pr.edu

Për të pasur një informacion paraprak më poshtë e gjeni një përmbledhje të shkurtë përmes abstraktit të temës.

Çdo sugjerim i juaji mund të jetë një pasurim i punës tonë !

UNIVERSITETI I PRISHTINËS "HASAN PRISHTINA"
FAKULTETI I BUJQËSISË DHE VETERINARISË
PROGRAMI STUDIMOR: SHKENCA BIMORE



Hulumtimi i disa specieve foragjere për tipare sasiore dhe cilësore në lokalitetin e Malisheves”

(Punim diplome)

MENTORI:
Prof. Dr. Imer Rusinovci

STUDENTI:
Bsc. Alban Krasniqi

Prishtinë, 2024

ABSTRAKTI

Parimet e sotme foragjer se: "Qumështi prodhohet në fushë, ndërsa milet në shtalla", apo "Logjika e mjeljes së lopëve shikohet nga goja e jo nga gjinjët e tyre", në agronomi përfaqësojnë praktikat e mira, që argumentojnë faktet, se pa ushqime të mira dhe të duhura të bagëtisë nuk mund të ketë prodhime sasiore e higjienike të sigurta të qumështit. Çështja e ushqimit të bagëtisë para se gjithash duhet t'a përfshijë ushqimin e duhur, përkatës dhe të normuar, duke mënjanuar kështu ushqimet e pahijeshme, të pa-përshtatshme dhe kequshqyerjet, në mënyrë që fermerët shumë qartë të arrijnë rezultate të mira.

Qëllimi i hulumtimeve tona, ishte që në pëzierjet foragjere të hulumtuara në fermën time familjare t'i përcaktojmë këto objektiva: rendimentin e materies së thatë, materiet minerale (Fe, Ca, K, Mg, P, Mn dhe Cu), përbërjen e fibrave të acidit detergjent (ADF), përbërjen e fibrave neutrale detergjente (NDF), proteinat (CP) dhe ligninën. Për llogaritje statistikore kemi përdorur paketën e Programit Statistikor SPSS - 19. Të dhënat janë analizuar sipas ANOVA-es, konkretisht sipas modelit për dallimet ndërmjet gjenotipeve të cilat ishin në hulumtim, modeli Duncan-it. Hulumtimet tona në pëzierjet foragjere, për rendiment të materies së thatë (MTH), dhanë rezultate me dallime sinjifikante. Vlerë më të lartë realizojë *Lolium multiflorum* (5.96 t/ha), ndërsa me vlerë më të ulët u karakterizua pëzierja foragjere: *Lutus corniculatus* + *Festuca rubra* (3.15 t/ha). Vlerë më të lartë për përmbajtje të Kalciumit (Ca) realizuam në gjenotipin *Lotus corniculatus* (25.61 g/kg), ndërsa vlerë më të ulët realizuam në gjenotipin *Lolium multiflorum* (2.47 g/kg), me dallime sinjifikante. Dallimet për përmbajtjen e Hekurit (Fe) që realizuam, ishin jo shumë të theksuara: *Lolium multiflorum* (0.393 g/kg) dhe *Festuca rubra* (0.12g/kg). Vlerë më të lartë të proteinave, realizuam te pëzierja foragjere (kombinimi): *Trifolium pratense* + *Lolium multiflorum* (11.38 %), ndërsa vlerë më të ulët të proteineve kemi realizuar në gjenotipin *Lotus corniculatus* (9.88 %). Lidhur me fibrat e acidit detergjent (ADF), vlerë më të lartë realizuam në bimët e gjenotipit *Festuca rubra* (39.57 %), ndërsa për fibrat neutrale detergjente (NDF), vlerë më të lartë të tyre realizuam në gjenotipin *Trifolium pratense* (72.63 %). Përmbajtje me vlerë më të lartë të ligninës, kemi realizuar në pëzierjen (kombinimin): *Trifolium pratense* + *Lolium multiflorum* (7.56 %), kurse vlerë më të ulët, realizuam në pëzierjen (kombinimin): *Lutus corniculatus* + *Festuca rubra* (5.53 %).

Fjalët kyçe: specie bimore, pëzierje foragjere, materie e thatë, rendiment, materie minerale.
